



UDHËRREFYES SPORTI

QARKU SIEGEN-WITTGENSTEIN

Informacione, këshilla & personat kontaktues



 **Kommunales
Integrationszentrum
Kreis Siegen-Wittgenstein**

LANDESSPORTBUND
NORDRHEIN-WESTFALEN



WO ICH HERKOMME? VOM SPORT!

Jamilon ist Düsseldorfer mit Migrationshintergrund und Bundestrainer der Frauen-Hockeynationalmannschaft. Vor allem aber ist er einer von 40 Millionen begeisterten Sportlerinnen und Sportlern, die Sportdeutschland zu dem machen, was es ist – einem der größten Förderer von Integration.

sportdeutschland.de
facebook/sportdeutschland
#sportdeutschland

IDHB
Deutscher
Hockey-Bund e.V.



WIR SIND
SPORTDEUTSCHLAND

DOSB



PËRMBAJTJA/IMPRESSUM

1. Sporti flet të gjitha gjuhët	4
2. Organizimi sportiv në Gjermani	5
• 2.1 Klubet sportive	5
• 2.2 Federatat sportive	5
• 2.3 Federatat profesionale sportive	5
• 2.4 Federata sportive e Landit	6
• 2.5 Federata olimpike gjermane	6
3. Klubi sportiv	7
• 3.1 Sporti në klub sportiv	8
• 3.2 Jeta në klub sportiv	8
• 3.3 Shkollimi dhe pjesëmarrja	9
4. Personat kontaktues në vend	10
5. Programi „integrimi përmes sportit“	11

Botues:

Federata sportive e Qarkut
Siegen-Wittgenstein e.V.
Bismarckstraße 45
57076 Siegen

Përgjegjës për Media:
Ottmar Haardt (Kryetar)

Personi kontaktues:
Christian Janusch

Tel.: 0271/41115
info@ksb-siegen-wittgenstein.de

Redaksia:

Christian Janusch

Fotomateriali:

LSB NRW, Andrea Bowinkelmann
KSB Siegen-Wittgenstein e.V.

2017

Botimi i parë

1. SPORTI FLET TË GJITHA GJUHËT

Sporti luan një rol të rëndësishëm tek secili njeri, pasi që njeriu me doemos lëviz çdo ditë. Pa marrë parasysh se çka, hudhja e mbeturinave, shkuarja në dyqan apo vizita nëpër shoqëri. Sporti i takon jetës sonë.

Por jo vetëm aspektet, si fuqia apo konkurrenca janë arsye, pse shumë njerëz e tejkalojnë masën e nevojshme në lëvizje në aktivitetet e tyre sportive. Ti pyesësh këta njerëz për arsye, për veqantinë e lëvizjeve të tyre, atëherë përgjigjetet e tyre janë të tilla si fitnesi, shëndeti, çlodhja dhe argëtimi.

Ndosha sporti me mundësitë e tij të shumfishta për lëvizjet ua ofron edhe juve këtë mundësi. Provojeni! Shumëllojshmëria e klubeve sportive

eksistuese dhe ofertat e tyre sportive ua japin mundësinë e gjetjes së pothuajse çdo lloji sporti. Në shumicën e rasteve edhe në afërsinë tuaj.

Pengesa e parë, e cila duhet tejkualuar është pjesëmarrja e parë në njërin nga ofertat. Për të i tejkualuar këto pengesa dhe ta kuptoni sportin në Gjermani, do ju prezantojmë në këtë „Udhërrëfyes“ bazat e sportit dhe klubeve tona sportive, si dhe personat kontaktues në vendet e caktuara.

Në këtë drejtim, kujdes të veçantë i kushtojmë njerzve, tek të cilët gjuha gjermane është një pengesë tjetër.

Për këtë arsye kemi publikuar broshurë edhe në gjuhë tjera. Ju dëshirojmë lexim të këndshëm dhe mos harroni: Sporti flet të gjitha gjuhët!





2. ORGANIZIMI SPORTIV NË GJERMANI

Në organizimin sportiv secili shtet ka karakteristikat dhe veqantitë e veta, me të cilat dallohet nga shtetet tjera. Në shumë shtete sistemi sportiv është i lidhur me shkolla dhe kështu bëhet organizimi sportiv përmes skuadrave shkollore. Ky sistem është i njohur nga Amerika.

Në Gjermani Sporti organizohet përmes klubeve sportive. Klubet sportive janë antare në Federata Sportive dhe në Federatat profesionale sportive. Këto dyja paraqesin dy shtylla në rrafshin e Land-it, të cilat paraqesin Federaten Sportive të Land-it duke shkuar në rrafshin shtetror në Federatën Sportive Olimpikë.

KLUBET SPORTIVE

Klubet sportive ua ofrojnë mundësinë më të madhe me llojet e ndryshme të sporteve. Në klube zhvillohet sporti.

Klubet paraqesin bazën e sistemit gjerman të sportit. Pasiqë në klube sportive zhvillohet kontakti i parë me sportin për të interesuarit e sportit, në pikën numer 3 do ta shjellojmë më tutje funksionin e klubit sportiv.

FEDERATAT SPORTIVE

Federatat sportive paraqesin kulmin e të gjitha klubeve sportive. Ketu nuk luan rol se çfarë për lloj sporti është fjala. Federatat sportive e kanë për detyrë, të i mbështesin klubet sportive dhe të përkujdesen për to.

FEDERATAT PROFESIONALE SPORTIVE

Në krahasim me Federatat sportive, federatat profesionale janë përgjegjëse për të gjitha sportet e njohura. Ato i mbështesin klubet sportive në organizimin edhe zhvillimin e sportit dhe pa-



DEUTSCHER OLYMPISCHER **SPORT**BUND



LANDESPORTBUND
NORDRHEIN-WESTFALEN



raçitjes së tij. Kur një klub është i specializuar për një sport, mirëpo ka oferta edhe për sporte tjera çon te mundësia, që ky klub të jetë antar i shumë federatave profesionale. Ka edhe raste kur klubet kanë oferta të ndryshme sportive mirëpo nuk i takojnë asnjë federate profesionale.

FEDERATA SPORTIVE E LANDIT (LSB)

Federata sportive e Land-it paraqet bashkimin e Federatave Sportive dhe Federatave profesionale Sportive në rrafshin e Land-eve. Federata Sportive e Land-it është përgjegjëse për kordinimin dhe organizimin e të gjitha poli-

tikave dhe temave specifike sportive brenda Land-it në bashkupim me Federatat dhe Federatat profesionale, të cilat gjinden brenda saj. Detyrë e veçant e Federatës sportive të Land-it është stërvitja e Trajnerave dhe udhëheqësve të ushtrimeve.

FEDERATA OLIMPIKE GJERMANE

Federata Olimpikë Gjermane paraqet kulmin e organizimit sportiv brenda Bundesrepublikës Gjermane. Ajo paraqet bashkimin e 16 Federatave Sportive të Land-eve dhe veqanërisht 82 Federatave Profesionale Sportive. Detyrat e Federatës Olimpikë Gjermane janë krijimi i kocepteve, zhvillimi i projekteve të reja kohore dhe bashkupimi me Ministrinë e Land-eve.

3. KLUBI SPORTIV

Njeriu, pa marrë parasysh i ri apo i moçëm ka interesa të ndryshme sportive, por edhe aftësi. Për këtë arsye njeri kërkon mundësi, me të cilat i përbush dëshirat e tij sportive. Shpesh, për hapin e parë nevojiten informacione, ndihmë apo edhe konsultime. Këto të gjitha, njeriu nuk i gjen vetëm në klube, por edhe nëpër dyqane sportive apo edhe në dyqane komerciale sportive.

Por çfarë e karakterizon ose e bën një klub sportiv të veçantë?

Shumica e klubeve sportive në Gjermani organizohen dhe udhëhiqen në baza vullnetare. Kjo dmth: që gati të gjithë personat, të cilët angazhohen në një mënyrë apo në ndonjë tjetër, shembull si udhëheqes së ushtrimeve, apo si kryetar, punojnë në baza vullnetare pa përfitime financiare. Mirëpo kjo formë e organizimit çon te pyetja tjetër:

Përse punojnë aq shumë njerëz pa pagë në klube sportive dmth në baza vullnetare?

Nje përgjigje e thjeshtë dhe e shpejtë për këtë pyetje nuk mund të gjindet, pasi që secili njeri ka arsyet e veta për praninë dhe punën e tij në një klub. Mirëpo në shumicën arsyt janë pak a shumë të ngjajshme. Më të shpeshtat janë:

1. Njeriu fillon si sportist/e aktiv/e në një klub të vijoj trajnimet dhe eventualisht merr pjesë në konkurset sportive. Lidhja me klub forcohet dhe njeriu

tenton ta mbështes klubin e vet sipas mundësisë.

2. Kur fëmiju fillon të jetë pjesë e një klubi dhe si Nënë/Baba i fëmijut, njeriu është shpesh i pranishëm në trajnime edhe në fundjavë gjatë ndeshjeve. Përmes kësaj rritet lidhja në mes të njeriut dhe klubit dhe puna intensivkohet. Mirëpo ky zhvillim është i parnishëm, pasi që klubi me pozitën e tij të veçantë, merr përsipër detyrat sportive dhe luan rol të rëndësishëm në sferat e tjera të jetës.



3.1 SPORTI NËPER KLUBE

Elementi qendror në klubet sportive është sporti i cili bëhet me kënaqësi dhe sukses. Pa marrë parasysh se çfarë sporti dhe klubi zgjedh njeriu, janë klubet në të cilat fëmijët, të rinjët dhe të rriturit ndihen mirë. Shpeshherë klubet ofrojnë edhe kurse për të antarësuarit.

Konkurrenca dhe sportet konkurruese: E gjithë përgatitja për ndeshjet sportive dhe për Ligat e ndryshme ndodhë brenda klubit. Trajneri apo Trajnerja e ka për detyrë planifikimin dhe zhvillimin e njesive trajnuese. Për shumicën e sporteve, pjesëmarrja në ndeshjet e ndryshme nëpër Liga sportive ka si kriter antarësinë e një klubi sportiv. Për këtë arsye klubi sportiv paraqet bazën e sportit.

Sporti i kohës së lirë: Jo secili njeri e ka motivimin të marrë pjesë në sportin e tij, nëpër ndeshje të ndryshme ose

të jetë pjesëmarrës në ndonjë Ligë. Shumë dëshirojnë vetëm të mbesin „aktiv“ në sport, ndonjëher të provojnë ndonjë sport të ri, apo vetëm kanë kënaqësi në lëvizje së bashku me të tjerët. Të gjitha këto mundësi i ofron klubi.

Sporti i shëndetshëm: Efektet pozitive të sportit për shëndetin dihen. Lëvizja është e shëndetshme dhe si e tillë mund të ndal smundjet e ndryshme apo të i ul ankesat e sëmundjeve. Njeriut nuk i nevojitet gjithmonë medicina. Për këtë arsye numri i ofertave speciale sportive po rritet me kalimin e kohës. Këtu numrojmë si shembull kurset për pjesët e ndryshme të trupit si shpinës, muskujve dhe qarkullimit të gjakut për njerëz me mbipeshë, vrapimi në ujë. Ofertat e ndryshme dallojnë nga njëra tjetra në oferta preventive dhe rehabilitative, të cilat në shumicën e rasteve paguhen nga sigurimi shëndetësor.

3.2 JETA NË KLUB SPORTIV

Ka edhe aspekte tjera, të cilat e bëjnë atraktive antarsinë në një klub, e jo vetëm antarësia:

Aspektet sociale: Për shumë antar përparësitë sociale luajnë një rol të veçantë. Përmes antarsisë në klub njeriu njofton shpejt dhe jo komplikuar njerëz të ndryshëm. Interesi i përbashkët në sport mundëson kontaktin tek njezit tjerë dhe krijon shpejt bazën për shoqëri të reja, të cilat qëndrojnë edhe jashtë klubit. Shokët e zënë përmes klubit janë ndryshe nga shoqëritë nga sferat e tjera, pa marrë parasysh gjend-





jen sociale apo prejardhjen e individit. Edhe me vonë në jetën profesionale aktiviteti dhe angazhimi në klub shihet në mënyrë pozitive, pasi që këtu ndërlihen me njëra tjetrën karakterisika si aftësia e punës në ekip, gadishmëria në punë, disciplina etj.

Stërvitja dhe specializimi: Struktura e klubeve kushtëzon shpesh ndërrimin e Trajnerave, të cilët angazhohen në klub. Që të mund të i kushohet kujdesi i nevojshëm stërvitjes dhe specializimit ka oferta të cilat lidhen me sportet e caktuara dhe oferta të cilat janë të lidhura me sportin në përgjithësi.

Këto rrugë të kualifikimeve ofrojnë përpos shkollës dhe punës mundësi të mira dhe të volitshme, për perspektiva të reja profesionale. Këso profesione shpesh janë të mirëpritura në aplikime për punë të re. Shpeshherë kostot

e këtyre stërvitjeve dhe specializimeve i merr përsipër klubi, kur trajnerët më pas punojnë për një kohë të caktuar në klub.

3.3 SHKOLLIMI DHE PJESMARRJA

Pas hyrjes në fuqi të Ligjit „Shkollimi dhe Pjesmarrja“ të rinjët deri në moshën 18 vjeqare kanë mundësinë për mbështetjeve të caktuara në rrafshin shkollor dhe pjesmarrjes sociale në bazë të ligjit të drejtave sociale (SGB II), në bazë të ligjit të drejtave sociale XII ose në bazë të ligjit shtetëror për shtesat e fëmijëve.

Zyra për punësim në vendin përkatës jep konsultat për aplikimin, ndihmon për pagesën e pjeshme apo totale të antarsisë në klub. Kjo ua lehtëson shumë të rinjëve rrugën për pjesmarrje në një klub.

PERSONAT KONTAKTUES

Keni interes të merreni me ndonjë sport në një klub? Këtu gjeni disa informacione edhe persona për kontakt , të cilët ua lehtësojnë rrugën për antarsim në një klub.

» **Kreissportbund Siegen-Wittgenstein e.V.**

Bismarckstraße 45, 57076 Siegen

Tel. 0271/41115

E-Mail: info@ksb-siegen-wittgenstein.de

Internet: www.ksb-siegen-wittgenstein.de



» **Sportjugend im KSB Siegen-Wittgenstein e.V.**

Bismarckstraße 45, 57076 Siegen

Tel. 0271/41115

E-Mail: info@die-sportjugend.de

Internet: www.die-sportjugend.de



» **Klubet e qyteit dhe bashkësisë në Qarkun Siegen-Wittgenstein**

SSV Bad Berleburg
Tel. 02751/959080
jensundnadine@gmx.net

GSV Burbach
Tel. 0160/2813397
sebhuettemann@web.de

SSV Erndtebrück
Tel. 02753/4179
benmax1@gmx.de

SSV Freudenberg
Tel. 02734/4789120
info@ssv-freudenberg.de

SSV Hilchenbach
Tel. 02733/2495
helmut.treude@skiverein-luetzel.de

SSV Kreuztal
Tel. 02732/762695
michaelnothacker@tv-littfeld.de

SSV Bad Laasphe
Tel. 0152/55626907
rolfdavidis@yahoo.de

SSV Netphen
Tel. 02738/4533
hjwerthenbach@aol.com

SSV Neunkirchen
Tel. 02735/781334
prinz-n@t-online.de

SSV Siegen
Tel. 0271/3177401
info@stadtsportverband-siegen.de

GSV Wilnsdorf
Tel. 0271/399663
gsv-wilnsdorf@web.de



„INTEGRIMI PËRMES SPORTIT“

Sporti është motori i integrimit, sepse ku tjetër përpos në sport, takohen njerëz të prejardhjeve të ndryshme për aktivitete të përbashkëta? Njerëzit me prapavijë migrative janë në sportin e organizuar shumë pak të prezantuar. Shpeshherë klubet nuk i kanë ofertat për njerëzit nga familjet imigrante. Shpesh mungojnë lokalet, personeli apo edhe mjetet financiare, që të mund ti integrojnë migrantët në bashkësinë e jetës në klubet sportive.

Ne i mbështesim klubet sportive në Qarkun Siegen-Wittgstein në përpjekjet e tyre, të promovojnë idetë dhe projektet e tyre si

Mjetet sportive, udhëheqsit e ushtrimeve, qiramarrjen e hallave sportive

Aksione si kurse dhe aktivitete të kohës së lirë

Stërvitjen dhe specializimin e trajnerve

Për ta promovuar dhe mbështetur financiarisht angazhimin e bërë në këtë drejtim dhe për pjesëmarrjen në programin shtetror „Integrimi përmes Sportit“, klubet mundën të çertifikohen si Klube Mbështetëse „Integrimi përmes Sportit“. Këto klube mbështetëse angazhohen vazhdimisht në çështjet e integrimit, kanë oferta për klube në bazë të nevojave, mundësi dhe oferta adekuate.

Klubet Mbështetëse përfitojnë mbështetje financiare prej 500-5000 Eur në vit. Mbështetja është e kufizuar në 5 vite.

Klubet, të cilat kanë interesa të bëhen Klube Mbështetëse në zonën „Integrimi përmes Sportit“, duhet të drejtohen zyrës së Kreissportbund Siegen-Wittgenstein.



Gesundheit *vorbessern.* Auch die Abwehrkräfte.

Wir sind da, damit Sie „vorbessern“ können: versorgen und verbessern – z. B. mit der individuellen Ernährungsberatung für ein schlagkräftiges Immunsystem.

**AOK NORDWEST –
Gesundheit in besten Händen**

aok.de/nw

Jetzt wechseln und #vorbessern